

STATUTI DHE AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“INTELISOFT LAB” SH.P.K.

Mbështetur në ligjin nr. 9901 datë 20.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare”, në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për QKB”, **sot më datë 22 Tetor 2021** me vullnetin e lirë dhe të plotë vendosëm të krijojmë dhe miratojmë statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “**INTELISOFT LAB**” **Sh.p.k.** me këtë përmbajtje

Neni 1 – Forma dhe emërtimi.

Shoqëria “**INTELISOFT LAB**” **Sh.p.k.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, subjekt juridik shqiptar, veprimtaria e së cilës do të rregullohet me anë të këtij Statuti dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.


Ky statut është përpiluar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter të detyrueshëm për nënshkruesit e tij. Çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Themeluesit.

Themeluesi i shoqërisë “**INTELISOFT LAB**” **Sh.p.k.** është:

- **Z. Herald Kapaj**, shtetas shqiptar, lindur më 11.11.1991 në Tirane, Shqipëri dhe banues në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftim nr. 034652125 dhe me numër personal J11111062N, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

-**Z. Senad Haxhija**, shtetas shqiptar, lindur më 30.07.1991 në Shkoder Shqipëri dhe banues në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftim nr. 033614157 dhe me numër personal J10730110K, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;



Neni 3 – Selia.

Shoqëria “INTELSOFT LAB” Sh.p.k. e ka selinë në:, Tirane Tirane TIRANE Rruga Komuna e Parisit, zona kadastrale 8270, nr.pasurie 8/883, Kodi Unik 8270066204...

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm me vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

Neni 4 – Objekti.

Shoqëria “INTELSOFT LAB” Sh.p.k. do ketë si objekt të veprimtarisë: a) Prodhimi, shitja dhe asistenca e software dhe rrjeteve informatike, mbajtja, riparimi dhe marrja me qira e pajisjeve dhe mjeteve elektronike per perpunimin e te dhenave; menaxhimi i qendrave te perpunimit te te dhenave dhe te rrjeteve informatike te cdo lloji; menaxhimin e kurseve per informatike dhe organizim te ndermarrjes; tregetim me shumice dhe pakice, perfshire ate elektronik, te pajisjeve dhe objekteve, hardware, aksesoret e tyre, mobilje dhe pajisjet per zyra, software, me dhe pa depozite per shitjen e software, rrjeteve informatike, hardware dhe objekteve ne pergjithesi per perpunimin e te dhenave si dhe sherbimeve te lidhura me to. Zhvillim software, platforma dixhitale, ecommerce. Lidhur me aktivitetin e permendur me siper, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, mbetet e kuptuar se detyra te tilla profesionale do t'i ngarkohen drejteperdrejt profesionisteve, rregullisht te aktivizuar ne varesi te rastit, nen pergjegjesine e tyre. Shoqeria mund te punesoje dhe te pranoje agjenci, komisione, perfaqesim dhe mandatim. Pergatitja dhe mirembajtja e faqeve te internetit, ofrim domain-esh, sherbime web hosting, sherbimeve te telekomunikacionit, pergatitja dhe mirembajtja e rrjeteve sociale ne internet si 2 dhe marketing online, mirembajtja dhe riparimi i kompjuterave dhe rrjeteve te komunikimit si dhe sherbime te tjera informatike.Hartim dhe implementim projektesh ne fushen e teknologjise se informacionit. Zhvillim. software, platforma



dixhitale, ecommerce dhe shitja e programeve kompjuterike per perdorim ne fusha te ndryshme. Ofrimi i sherbimeve te ndryshme informatike ne fushen e teknologjise se informacionit. Sherbime marketing ne fushen e monitorimit te medias elektronike dhe te shkruar, perpunime statistikore, Publikime, dhenie informacioni online, media te shkruara, media audio-vizive, sherbime ne fushen e perkthimit etj. Konsulenca ne lidhje me aplikimin e teknologjise se informacionit ne fusha te ndryshme. Importimi dhe shitja e hardware-ve per perdorim ne fushen e teknologjise se informacionit. Shoqeria do te kryeje pa kufizim cdo aktivitet tjetër te lejueshem nga legjislacioni ne fuqi edhe pse jo i permendur ne kete akt. Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të cilat kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo ndihmës me të. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojnë përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakëve.. Çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

Shoqëria **“INTELSOFT LAB” Sh.p.k.** ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj me vendim të Asemblesë së përgjithshme të ortakëve.

Neni 4 – Kohëzgjatja.

Shoqëria **“INTELSOFT LAB” Sh.p.k.** kryen veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e përgjithshme e ortakëve.



Neni 5 – Kapitali themeltar.

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë “INTELSOFT LAB” Sh.p.k. është 100 000 (njëqinde mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtme:

- Ortaku themelues **Z. HERALD Kapaj**: zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50 000 (pesdhjete mijë) lekë që përbën **50% të kapitalit themeltar** të shoqërisë;
- Ortaku themelues **Z. SEAD Haxhija**: zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50 000 (pesdhjete mijë) lekë që përbën **50% të kapitalit themeltar** të shoqërisë;


Kapitali themeltar është i nënshkruar plotësisht nga ortaku themelues në masën 100%. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme / të paluajtshme apo të drejta). Ortaku përgjigjen për humbjen e shoqërisë përkundrjet të tretëve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6 – Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.

Kapitali i shoqërisë “INTELSOFT LAB” Sh.p.k. mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga Gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica e ortakëve nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e Statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



Neni 7 – Transferimi i kapitalit.

Kuotat e kapitalit të shoqërisë “INTELSOFT LAB” Sh.p.k. e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; d) dhurimit; e) çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj.

Në rast transferimi të kuotës së kapitalit themeltar tek një subjekt i tretë, ortakët e tjerë të paktën 30 (tridhjetë) ditë para duke i venë në djeni mbi kushtet e transferimit. Ortakët e tjerë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i sipërpërmëndur mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes me të njëjtat kushte.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa kohë nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 – Organi vendimarrës. Asambleja e përgjithshme të ortakëve.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme: a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) emërimin, shkarkimin dhe përcaktimin e shpërblimeve të administratorëve; c) emërimin e shkarkimin, dhe përcaktimin e shpërblimeve të likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre; h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimentet e tjera ndaj administratorëve; i) riorganizimin e shkriren e shoqërisë; l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë; m) çështje të tjera të miratura nga ligji apo statuti.



Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së përgjithshme, e cila mund të përfshijë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 – Organi vendimarrës. Asambleja e përgjithshme e ortakëve.


Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 – Kuorumi.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, votojnë personalisht, me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.



Nëse Asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 – Marrja e vendimeve.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos me tre të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje tjera si: a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve; c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; d) përcaktimin e shpërblimeve; e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 – Përjashtimi nga e drejta e votës.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.





Neni 13 – Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme së ortakëve:

- **Z. Herald Kapaj**, shtetas shqiptar, lindur më 11.11.1991 në Tirane, Shqipëri dhe banues në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftim nr. 034652125 dhe me numër personal J11111062N, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;


specimenë e nënshkrimit

Neni 14 – Kompetencat e administratoreve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të: a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare; c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të



Regjistrimit; g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e aktiviteteve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur: a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim; c) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 (pesë) për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara; d) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 (pesë) për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.


Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 - Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.



Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet: a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; d) të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë; e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme: a) u kthen ortakëve kontributet; b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë; c) u shpërndan aktivet shoqërisë; d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16 - Viti Financiar dhe dispozita të përkohshme mbi ndarjen e fitimeve të shoqërisë.

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjatë vitit, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.


Neni 17 - Prishja dhe likuidimi i shoqërisë.

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë: a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; b) me vendim të Asamblese së Ortakëve; c) me hapjen e procedurave të falimentimit; c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”; d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtimin shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.



Neni 18 - Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20 - Baza Ligjore


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, e Kodit Civil dhe të çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21 – Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
INTELSOFT LAB


Z. Herald Kapaj


Z. Senad Haxhija